

## **PROCES – VERBAL -- Tipi i kontratës - Shërbime**

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

#### **OBJEKTI I PROCEDURËS:**

“Blerje bileta të transportit ajror ndërkombëtar me destinacion Bruksel”.

Kodi Përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 34980000- 0

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **ALBCONTROL SHA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **I. KRITERET E PËRGJITHSHME / VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

- 1.1** Rezervimin e biletës, sipas destinacionit të kërkuar me itinerare të detajuara, duke përfshirë klasin, sasinë, statusin dhe të dhëna të tjera alfanumerike që kanë të bëjnë me segmentet e udhëtimit si dhe kodin e llogarisë së klientit.
- 1.2** Operatori ekonomik quhet të paraqesë ekstraktin e regjistrit historik dhe tregtar lëshuar nga QKB, ku aktiviteti tregëtar të jetë objekt i kësaj procedure.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme bazohet në Udhëzim nr. 03 Datë 18.06.2021 ”Mbi përdorimin e sistemit dinamik për blerjen e biletave të transportit ajror ndërkombëtar dhe zhvillimin e tyre me mjete elektronike” si dhe bazuar në nenin 77 ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

##### **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Specifikimet teknike janë hartuar duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për shërbimet objekt procedure prokurimi, duke marrë në konsideratë karakteristikat dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, te Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.*

Specifikimet teknike janë vendosur sipas urdhrorit për dërgim me shërbim jashtë shtetit.

Blerje biletë Tiranë – Bruksel - Tiranë

Nisja: Tiranë - Bruksel më 25/08/2021

Kthimi: Bruksel - Tiranë më 26/08/2021

**Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.**